

Nr. 2877/1 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 22 . 06 . 2026



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

DIVIZIONI TEKNIK

DEPARTAMENTI ELEKTRO-MEKANIK

TERMA REFERENCE DHE SPECIFIKIME TEKNIKE


Mirëmbajtja e sistemit DMDC në KESH për 3 vite dhe upgrade për integrimin e kapaciteteve të reja gjeneruese

1. TË PËRGJITHSHME

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a., është shoqëri aksionere me kapital të zotëruar 100 % nga Shteti shqiptar, sipas aktit të themelimit, datë 17.10.1995. Misioni i shoqërisë është realizimi i prodhimit të energjisë elektrike, përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik dhe komercializimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj nëpërmjet:

- Shfrytëzimit me efektivitet të burimeve hidrike të lumit Drin,
- Mirëmbajtjen me cilësi të aktiveve,
- Rritjen e sigurisë dhe jetëgjatësisë së veprave,
- Angazhimin për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe komunitetit, që ndikohet prej veprimtarisë së KESH sh.a.
- Krijimit dhe përmirësimit të infrastrukturës për operimin e sigurtë gjatë shfrytëzimit të veprave të HEC-Fierzë, HEC-Koman, HEC-Vau i Dejës

Paraqitja skematike e kaskadës së lumit Drin:



[Handwritten signatures]

Gjatë periudhës 2022-2023, në KESH Qendër Tiranë u realizua platforma DMDC e monitorimit të digave dhe e sistemit të kontroll-monitorimit të 3 HEC-ve Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës (Dam monitoring and dispatch center). Ky projekt u zbatua nga KONČAR-KET Ltd. Në kuadër të këtij projekti, u instalua platforma e kontroll-monitorimit SCADA "PROZANET", së bashku me pajisjet e këtij sistemi hardware dhe software.

Kjo platformë konsiston në pajisjet hardware dhe në software, të cilat janë të instaluar në zyrën e Dispeçerisë KESH Qendër Tiranë, në qendrën e backup, e cila është instaluar në server-room në HEC Vau i Dejës, si dhe në pajisjet e gateway redundante, që janë të instaluar në secilin HEC.

Nëpërmjet platformës "PROZANET", kryhet kontrolli dhe monitorimi i HEC-ve në distancë, gjithashtu monitorimi në kohë reale dhe vizualizimi i të dhënave dhe grafikëve të ndryshëm në video-wall, një sistem i nevojshëm dhe tepër i domosdoshëm për kontrollin dhe menaxhimin e prodhimit të energjisë elektrike nga operatorët e Dispeçerisë të KESH sh.a. për 3 HEC-et Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës. Pra mund të themi se kjo platformë është një nga sistemet më të rëndësishme për kontrollin dhe monitorimin e HEC-eve në KESH sh.a.

Duke qenë se është një platformë e nivelit të lartë të sistemeve SCADA, shpeshherë shfaqen probleme dhe difekte të ndryshme, të cilat pengojnë vazhdimin normal të punës së Dispeçerisë në KESH Qendër, si rrjedhojë pengojnë në përditësimin në kohë reale të gjenerimit të energjisë elektrike nga HEC-et dhe krahasimin e tij me planifikimin e kryer, duke u bërë shkak për krijimin e disbalancave në Sistemin Energjitik që menaxhohet nga OST. Këto probleme teknike të platformës DMDC, deri në një nivel të caktuar janë zgjidhur nga specialistët e KESH sh.a., por për problemet dhe difektet e një niveli ekspertësh, është i nevojshëm suporti nga specialistët përkatës të prodhuesit të kësaj platforme, pasi ofron ekspertizën dhe zgjidhjen optimale.

2. QËLLIMI.

Platforma DMDC e monitorimit të digave dhe e sistemit të kontroll-monitorimit të 3 HEC-ve Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës (Dam monitoring and dispatch center), konsiston në:

1. Pajisjet hardware dhe në software, të cilat janë të instaluar në zyrën e Dispeçerisë KESH Qendër Tiranë.
2. Në qendrën e backup, ku pajisjet hardware dhe software janë instaluar në server-room në HEC Vau i Dejës.
3. Pajisjet e gateway redundante, që janë të instaluar në secilin HEC: Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës.

Platforma qendrore DMDC e instaluar në KESH Qendër, nëpërmjet gateway komunikon dhe merr të dhënat në kohë reale nga sistemet e kontroll-monitorimit ekzsituase lokale në secilin HEC.

Këto të dhëna ruhen në serverat e DMDC në KESH qendër, si dhe sinkronizohet dhe i ruan këto të dhëna për arsye sigurie edhe në qendrën e backup të DMDC në HEC vau i Dejës.



Enti Rregullator i Energjise (ERE) ka miratuar me Vendim Nr.126, datë 30.07.2020 “Rregullore për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe për t’u theksuar është fakti se edhe nga Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), si institucioni përgjegjës për Sigurinë Kibernetike në Republikën e Shqipërisë, ka propozuar dhe më anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15.07.2020 "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit" ka shpallur Sistemet DCS-SCADA si “Infrastrukturë Kritike të Informacionit” në Republikën e Shqipërisë pasi ka kryer auditimin e sistemeve teknologjike dhe informatike dhe rrjedhimisht vetë KESH sh.a. si “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit”.

Sa më sipër, për arsye të sigurisë kibernetike, me implementimin e gateway të reja në secilin HEC, kur është zbatuar implementimi i platformës DMDC, u krye edhe një upgrade i protokollit të komunikimit nga IEC 60870-5-104, në IEC 60870-5-104 S (secure), duke implementuar fillimisht serinë e standartit të sigurisë IEC 62351.

Platforma DMDC është furnizuar dhe instaluar nga KONČAR-KET Ltd dhe ka përfunduar në vitin 2023.

Por garancia dhe suporti nga Prodhuesi i këtij sistemi kanë përfunduar, prandaj për të siguruar një operim të sigurtë të kësaj platforme, është planifikuar një shërbim mirëmbajtje 3-vjeçar, ku përfshihet pjesa hardware dhe software, integrimi i kapaciteteve të reja gjeneruese duke importuar dhe vizualizuar në ndërfaqen e sistemit SCADA PROZANET sinjalin e fuqisë aktive të gjeneruar në kohë reale nga: TEC-et lundruese Tigër 1&Tigër 3 (totali i fuqisë aktive për të dyja), PV Qyrfaq, PV Zadejë dhe PV Karavasta. Në këtë projekt gjithashtu do të përfshihet trajnimi i avancuar në fabrikë i stafit inxhinier të KESH sh.a. Qëllimi është që në përfundim të kontratës së shërbimit 3-vjeçar të rritet niveli profesional i stafit inxhinier.

3. PËRSHKRIMI I PLATFORMËS DMDC.

Përshkrimi i arkitekturës së sistemit DMDC përmban:

- **Arkitektura e platformës DMDC.**
- **Pajisjet hardware të platformës DMDC.**
- **Komponentët e software të platformës DMDC.**



3.1 Arkitektura e platformës DMDC.




Fig.1. Arkitektura e platformës DMDC.

3.2 Pajisjet hardware dhe komponentët software të platformës DMDC.

Platforma DMDC (Dam monitoring and dispatch center), konsiston në:

1. Platformën kryesore të DMDC të instaluar në zyrën e Dispçerisë KESH Qendër Tiranë.
2. Në qendrën e backup të DMDC, të instaluar në server-room në HEC Vau i Dejës.
3. Pajisjet e gateway redudante, që janë të instaluara në secilin HEC: Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës.

[Handwritten signatures]

Platforma kryesore të DMDC e instaluar në zyrën e Dispeçerisë KESH Qendër Tiranë përbëhet nga pajisjet hardware dhe software si më poshtë:

- SCADA Server A Lenovo Thinksystem, SR630 V2 ;
- SCADA Server B Lenovo Thinksystem, SR630 V2 ;
- Backup i të dhënave QNAP 12-bay për RACK, NAS, AMD Ryzen v1000 seria v1500B ;
- Dy printerat me ngjyra Xerox VersaLink C7 100 A3, ku përfshihet edhe KIT C7130 dhe 320 GB Hard disk për secilin printer ;
- Router-i për mirëmbajtjen remote Pajisje Milesight me suport për 4G, Wi-Fi dhe GPS, me dy karta SIM, një portë M.2 NVMe SSD dhe 5 porta Gigabit Ethernet (1 WAN + 4 LAN) ;
- Dy Terminallet e administrimit Lenovo Thinksystem me monitor 18.5" LCD (Console) ;
- Operator workstation computer me 2 monitorë (HP WKS Z2 G8 TW) ;
- Operator workstation computer me 2 monitorë (HP WKS Z2 G8 TW) ;
- UPS për furnizimin me energji të pandërprerë me S3T Active, kabinet me lartësi 1025 mm, hyrje 3-fazore / dalje 3-fazore. Përfshihet software për Windows/Linux, bateri BB 1900 480V V6, fuqi nominale 20 kVA ;
- Ethernet Switch Cisco Catalyst 9300L me 24 porta Ethernet për data, paketë Network Essentials dhe 4 uplink 10 Gigabit për rrjetin e komunikimit të pajisjeve Network 1 ;
- Ethernet Switch Cisco Catalyst 9300L me 24 porta Ethernet për data, paketë Network Essentials dhe 4 uplink 10 Gigabit për rrjetin e komunikimit të pajisjeve Network 2 (redudant) ;
- Kontrolleri për Video Wall, HP Workstation Z4 G4 me tastierë, maus dhe kartë grafike për 12 ekrane ;
- Monitorë Video Wall, 12 copë × Vestel WW55B/2HB 55", ekrane Video Wall ultra të hollë, ekrane LCD industriale me rezolucion të lartë, ku përfshihet edhe struktura mbajtëse për Video Wall ;
- Laptopi dhe hard disk-u i jashtëm Lenovo NB, 5 15ITH6 si dhe memoria e jashtme me hapësirë 2 GB (External HDD), ku janë ruajtur backup-et e platformës DMDC ;
- Rack-u ;
- Dy Sisteme operative për dy serverat: Microsoft Windows Server 2019 Standard ROK (16 bërthama) – shumëgjuhësh;
- Sistemi operativ për kontrollerin e video wall Microsoft Windows 10 Pro;
- Sistemi operativ për laptop Microsoft Windows 11 Pro;
- Dy Sisteme operative për dy operatorët Microsoft Windows 11 Pro për Workstations ;
- Dy Sisteme SCADA Konçar PROZA NET versioni 3.6 për dy serverat A dhe B;
- Dy sisteme Baza të të dhënave SCADA Microsoft SQL Server Standard 2019 për dy serverat A dhe B;
- Dy driverat për krijimin e Gateway 1 dhe 2 për komunikimin me anë të protokollit IEC 60870-5-104 S (secure) të dy serverave A dhe B për importimin e sinjaleve dhe të dhënave nga sistemet e kontroll-monitorimit në 3 HEC-et: Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës;



Qendra e backup të DMDC, e instaluar në server-room në HEC Vau i Dejës përbëhet nga pajisjet hardware dhe software si më poshtë:

- SCADA Server A Lenovo Thinksystem, SR630 V2 ;
- SCADA Server B Lenovo Thinksystem, SR630 V2 ;
- Backup i të dhënave QNAP 12-bay për RACK, NAS, AMD Ryzen v1000 seria v1500B ;
- Dy Termialet e administrimit Lenovo Thinksystem me monitor 18.5" LCD (Console) ;
- Ethernet Switch Cisco Catalyst 9300L me 24 porta Ethernet për data, paketë Network Essentials dhe 4 uplink 10 Gigabit për rrjetin e komunikimit të pajisjeve ;
- Router-i për mirëmbajtjen remote Pajisje Milesight me suport për 4G, Wi-Fi dhe GPS, me dy karta SIM, një portë M.2 NVMe SSD dhe 5 porta Gigabit Ethernet (1 WAN + 4 LAN) ;
- Serveri për sinkronizimin e kohës Meinberg M320/GPS/3GE/PP-2/AD10 ;
- Dy Sisteme operative për dy serverat: Microsoft Windows Server 2019 Standard ROK (16 bërthama) – shumëgjuhësh;
- Dy Sisteme SCADA Konçar PROZA NET versioni 3.6 për dy serverat A dhe B;
- Dy sisteme Baza të të dhënave SCADA Microsoft SQL Server Standard 2019 për dy serverat A dhe B;

Në HEC Fierzë në platformën e DMDC përfshihen pajisjet hardware dhe software si më poshtë:

- Dy copë Gateway për komunikimin me protokoll IEC 60870-5-104 S (secure), e nivelit Kompjuter industrial Konçar, 16 GB RAM, 480 GB SSD, i3-1115G4E, HDMI, VGA, model MOS-2120-Z1101E, Windows 10 IoT LTSC, set montimi në mur AMK-W006;
- Dy copë Licenca për protokollin e komunikimit Licencë IEC 104 Forwarder;
- Dy Sisteme operativ për gateway Microsoft Windows 10 IoT Enterprise 2019 LTSC;

Në HEC Koman në platformën e DMDC përfshihen pajisjet hardware dhe software si më poshtë:

- Dy copë Gateway për komunikimin me protokoll IEC 60870-5-104 S (secure), Siemens SICAM A8000. Secila gateway A800 përbëhet nga ;
 - moduli furnizimi me energji DC110–220V, 45W;
 - moduli master CP-8050 Siemens 6MF2;
 - moduli i rrjetit të komunikimit Ethernet CI-8520**
- Dy Switch-at e konfigurueshëm CISCO 1E3200-8T2S-E;
- Licenca për redundancën e dy gateway A8000: CP-8050, redundante DL Siemens 6MF2750-2RE00;

Në HEC Vau i Dejës në platformën e DMDC përfshihen pajisjet hardware dhe software si më poshtë:

- Dy copë Gateway për komunikimin me protokoll IEC 60870-5-104 S (secure), e nivelit Kompjuter industrial Konçar, 16 GB RAM, 480 GB SSD, i3-1115G4E, HDMI, VGA, model MOS-2120-Z1101E, Windows 10 IoT LTSC, set montimi në mur AMK-W006;



- Dy copë Licenca për protokollin e komunikimit Licencë IEC 104 Forwarder;
- Dy Sisteme operativ për gateway Microsoft Windows 10 IoT Enterprise 2019 LTSC;

Operatorët janë konfiguruar me nivele të ndryshme kontrolli: vetëm monitorim ose për supervizionin dhe kontrollin e procesit të prodhimit të Energjisë nga agregatët e 3 HEC-eve Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës.

4. DETYRAT DHE KËRKESAT TEKNIKE PËR MIRËMBAJTJEN 3-VJEÇARE TË PLATFORMËS DMDC.

Shërbimi i Mirëmbajtjes, i cili kërkohet të realizohet nëpërmjet këtij projekti, do të mbulojë:

- 24/7 Shërbimi i suportit në distancë nga specialistët e Prodhuesit të platformës DMDC nëpërmjet telefonit ose konektimit në remote nëpërmjet VPN, ku përfshihen gjithë pajisjet përbërëse të saj hardware dhe software të përshkruara më sipër;
 - Punimet në vend për riparimin e defekteve dhe mirëmbajtjen parandaluese për të gjitha pajisjet hardware dhe software të platformës DMDC nga specialistët e Operatorit ekonomik që do të zbatojë projektin. Lista e specialistëve të OE, duhet të jetë e miratuar nga Prodhuesi i Sistemit SCADA PROZANET ekszitues, për arsye të sigurisë dhe garantimit të aftësive teknike të specialistëve që do të kryejnë procese pune në sistemin SCADA;
 - Mirëmbajtja në remote çdo 3-muaj, për minimumi dy ditë suport çdo herë të moduleve të komunikimit të platformës SCADA DMDC, bazës së të dhënave, importimit të të dhënave, backup të të dhënave dhe gjenerimin e një raporti nga Prodhuesi i Platformës DMDC, ku të përshkruhen me detaje proceset e punëve të kryera;
 - Gjenerimi i një raporti çdo 3-muaj nga operatori ekonomik që do të kryejë këtë projekt, i miratuar nga Prodhuesi i platformës ekzistuese SCADA DMDC PROZANET, ku të përshkruhen me detaje proceset e punëve të kryera, problemet që u gjetën nëse ka, mënyra që u zbatua për zgjidhjen e tyre nëse ka patur probleme;
 - Vizitë një herë në vit në KESH Qendër DMDC, të specialistëve të prodhuesit, për inspektimin total të platformës, pajisjeve hardware dhe software dhe gjenerimin e një raporti nga Prodhuesi i Platformës DMDC pas inpektimit në vend, ku të përshkruhen me detaje proceset e punëve të kryera, problemet që u gjetën nëse ka, mënyra që u zbatua për zgjidhjen e tyre nëse ka patur probleme. Nëse gjatë periudhës së mirëmbajtjes do të ketë ndryshime konfigurimesh, shtim sinjalesh, me qëllim që të kemi gjithmonë variantin e fundit të përditësuar duhet të kryhet nga specialistët e prodhuesit edhe backup i platformës DMDC tek Laptopi ekzistues i DMDC dhe tek HDD i jashtëm ekzistues i DMDC.
- Sqarojmë se vizita e parë për vitin e parë në KESH Qendër DMDC, duhet të kryhet brenda 3 muajve të parë pas lidhjes së kontratës, pasi është e nevojshme sepse platforma është pa mirëmbajtje dhe suport prej prodhuesit prej të paktën një viti, si rrjedhojë është e nevojshme kryerja site vizit. Ndërsa për dy vitet e tjera, kjo site vizit mund të kryhet në fund të vitit të dytë dhe vitit të tretë të mirëmbajtjes nga data e lidhjes së kontratës. Për çdo vizitë vjetore, duhet të gjenerohet një raport nga Prodhuesi i platformës ekzistuese SCADA DMDC PROZANET, ku të përshkruhen me detaje proceset e punëve të kryera, problemet që u gjetën nëse ka, mënyra që u zbatua për zgjidhjen e tyre nëse ka patur probleme;



- Integrimi i kapaciteteve të reja gjeneruese në sistemin SCADA DMDC PROZANET ekzistues, duke importuar dhe vizualizuar në ndërfaqen e sistemit sinjalin e fuqisë aktive të gjeneruar në kohë reale nga: TEC-et lundruese Tigër 1&Tigër3 (totali i fuqisë aktive për të dyja), PV Qyrmaq, PV Zadejë dhe PV Karavasta. Sqarojmë se:
Sinjali i fuqisë aktive i gjeneruar në kohë reale nga TEC-et lundruese Tigër 1&Tigër3 (totali i fuqisë aktive për të dyja) do të transmetohet nga Qendra NDC e sistemit SCADA të OST me protokollin ICCP. Detyrë e këtij projekti do të jetë vetëm importimi dhe vizualizimi në sistemin e KESH sh.a. SCADA PROZANET. Aktivizimi i këtij sinjali nga ana e OST dhe testimi i network të komunikimit për ndërlidhjen e SCADA DMDC KESH Qendër-SCADA OST është detyrë e KESH sh.a., pasi përfshihen infrastrukturat IT të OST dhe KESH sh.a.
Sinjali i fuqisë aktive i gjeneruar në kohë reale nga për PV Qyrmaq dhe PV Zadejë, do të importohet në SCADA DMDC kur të jenë importuar në sistemin e kontroll-monitorimit në HEC Vau i Dejës dhe të bëhen aktive për transmetimin nëpërmjet gateway ekzistuese në HEC Vau i Dejës.
Sinjali i fuqisë aktive i gjeneruar në kohë reale nga për PV Karavasta, do të importohet në SCADA DMDC kur të jetë importuar në sistemin e kontroll-monitorimit në HEC Koman dhe të bëhet aktiv për transmetimin nëpërmjet gateway ekzistuese në HEC Koman;
- Duhet të kryhet zgjerimi i licensës ekzistuese SCADA të Platformës DMDC në KESH Qendër me të paktën 1000 sinjale, pasi në të ardhmen parashikohet të kemi shtim të aseteve gjeneruese dhe sinjalet rezervë aktualisht të licensave ekzistuese pothuajse janë ezauruar dhe nuk mjaftojnë për HEC-et ekzistues nëse do të kemi shtim sinjalesh;
- Trajnim i avancuar në fabrikë (jashtë vendit) i specialistëve të KESH sh.a. për mirëmbajtjen e platformës DMDC “PROZANET”. Trajnimi duhet të jetë minimumi 5 (pesë) ditë pa përfshirë ditët e udhëtimit, ku duhet të marrin pjesë minimumi 5 (pesë) specialistë të KESH sh.a. Të gjitha shpenzimet ku përfshihet: Trajnimi, Hoteli, transporti Aeroport-Hotel dhe anasjelltas do të kryhen nga operatori ekonomik që do të zbatojë këtë projekt. Çdo specialist pjesëmarrës në përfundim të trajnimit, duhet të pajiset me çertifikatë trajnimi nga Prodhuesi;
- Në rast të defekteve ose dëmtimit të pajisjeve hardware të sistemit DMDC gjatë periudhës 3-vjeçare të mirëmbajtjes, do të jetë detyrë e OE që të kryejë riparimin e tyre ose zëvendësimin me pajisje të reja, kur pajisjet e dëmtuara nuk mund të riparohen, me qëllim rikthimin në gjendje normale pune të platformës DMDC “PROZANET” përfshirë pajisjet hardware dhe software të saj.
Aty ku pajisjet e reja kanë nevojë për konfigurime dhe parametrizime, do të jetë detyrë e operatorit ekonomik ti kryejë ato.

Shënim: Sistemi SCADA DMDC PROZANET është i zhvilluar dhe implementuar nga prodhuesi KONCAR. Operatori duhet të sigurojë suport nga vetë prodhuesi i sistemit për realizimin e detyrave dhe kërkesave në mënyrë që të garantohet që realizimi i punimeve nuk do të çënoje sigurinë e gjithë sistemit SCADA.



Në vijim jepen të përmbledhur në tabelë, të dhënat e reagimit/përgjigjes për ndërhyrjet e nevojshme gjatë ekzekutimit të kontratës, për suportin hot-line, për aksesin në distancë dhe për suportin në vend.

Suporti nëpërmjet Telefonit 24/7 (Hotline Support)	Koha e përgjigjes	2 (dy) orë pas njoftimit
	Shërbimi për suportin e kërkuar	Përfshihet: E hënë - e premte orari 08:00-17:00, 8 orë në ditë, për ditët e punës.
	Shërbimi për suportin e kërkuar në fundjavë.	Përfshihet: E shtunë, e dielë 24 orë si dhe përfshihet nga e hëna në të premte orarin 17:00-08:00 për ditët e punës.

Mirëmbajtja online në distancë (Remote Access)	Koha e përgjigjes (Response time)	4 (katër) orë pas njoftimit (4h after notification)
	Shërbimi për suportin e kërkuar	Përfshihet: E hënë- e premte orari 08:00-17:00 për ditët e punës
	Shërbimi për suportin në fundjave	Përfshihet: E shtunë, e dielë 24 orë si dhe përfshihet nga e hëna në të premte orari 17:00-08:00 për ditët e punës
	Para-kushtet	Akresi në rrjetin (network) e KESH për të kryer mirëmbajtjen në distancë online, do të sigurohet nga KESH sh.a.

Suporti i mirëmbajtjes në vend (On-Site Support)	Koha e përgjigjes	Brenda 10 ditësh pune nga kërkesa e KESH sh.a. Specialistët e prodhuesit duhet të jenë në KESH DMDC Qendër Tiranë 1 herë në vit;
	Para-kushtet	Akses në KESH Qendër Tiranë për specialistët që do kryejnë suportin on-site.



Suporti me telefon dhe mirëmbajtja në distancë.

Kostoja e suportit me telefon përfshihet tek kostoja e shërbimit të aksesit të mirëmbajtjes on-line në distancë (remote).

Suporti në vend (On-Site Support).

Suporti në vend në KESH DMDC Qendër Tiranë, duhet të shoqërohet me raportin nga specialistët e prodhuesit për ndërhyrjet që do të kryejnë.

Brenda muajit të parë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet të deklarojë me shkrim numrin e telefonit dhe adresën e emailit për komunikimin 24/7 për shërbimin e mirëmbajtjes. Në vijim, po paraqesim tabelën e zërave të preventivit të shërbimeve të kërkuara për mirëmbajtjen 3-vjeçare të Platformës DMDC KESH Qendër Tiranë.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1 Vendodhja

- Shërbimi i mirëmbajtjes 3-vjeçare për DMDC KESH Qendër Tiranë.

5.2 Data e Fillimit

Perioda e përgjithshme e zbatimit të kontratës do të jetë 36 muaj, nisur nga data e nënshkrimit të kontratës.

6. TRAJNIMI

Furnizuesi duhet të kryejë trajnim/Certifikim në ambientet e Prodhuesit mbi mirëmbajtjen dhe konfigurimin e platformës DMDC ekzistuese në tërësi për minimumi 5 (pesë) specialistë të KESH sh.a. për të paktën 5 (pesë) ditë pa përfshirë ditët e udhëtimit;

- Në trajnim përfshihen shpenzimet: Hoteli, Certifikatat për secilin specialist pjesëmarrës të KESH sh.a., transporti Aeroport-Hotel dhe anasjelltas.

Shënim:

Perioda me e përshtatshme e organizimit të trajnimit në fabrikë brenda afatit 3-vjeçar të zbatimit të kontratës, do të jetë subjekt i dakortësimit dypalësh. Njoftimi nga kontraktori duhet të bëhet të paktën një muaj përpara afatit të parashikuar, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e stafeve teknike, pjesëmarrëse në trajnim.



7. Lista e shërbimeve:

A	Suport on line në distancë 24/7 për platformën DMDC (hardware+software).				
Nr.	Shërbimet e mirëmbajtjes	Njësia	Sasia	Çmimi (LEK)	Total
1	Paketa e shërbimit të suportit të mirëmbajtjes online në distancë, e Hënë-e Premte 08:00-17:00, për ditët e punës për platformën DMDC (hardware+software).	Muaj	36		
2	Paketa e shërbimit të suportit të mirëmbajtjes online në distancë, E shtunë, e Dielë 24 orë për platformën DMDC (hardware+software).	Muaj	36		
3	Paketa e shërbimit të suportit të mirëmbajtjes online në distancë, e Hënë - e Premte 17:00-08:00 për shërbimin jashtë orarit të ditëve të punës për platformën DMDC (hardware+software).	Muaj	36		
SHUMA A					
B	Shërbimet për riparimin dhe mirëmbajtjen në vend, për platformën DMDC (hardware+software).				
1	Mirëmbajtje preventive në vend nga specialistët e autorizuar nga Prodhuesi të platformës DMDC (hardware+software), të përfshira dy ditë në çdo 3 muaj.	Set	12		
2	Vizitë dhe mirëmbajtje në vend një herë në vit në KESH Qendër për platformën DMDC, të specialistëve të prodhuesit.	Set	3		
SHUMA B					
C	Integrimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe Zgjerimi i kapacitetit të licensës ekzsituase				
1	Integrimi i kapaciteteve të reja gjeneruese në sistemin SCADA DMDC PROZANET, sipas specifikimeve.	Set	1		

2	Zgjerimi i kapacitetit të licensës ekzistuese SCADA të Platformës DMDC në KESH Qendër me të paktën 1000 sinjale.	Copë	1		
3	Zgjerimi i kapacitetit të licensës ekzistuese SCADA të Platformës DMDC backup në HEC Vau i Dejës me të paktën 1000 sinjale.	Copë	1		
SHUMA C					
D	Trajnim i avancuar tek Prodhuesi për platformën DMDC				
1	Trajnim i avancuar sipas specifikimeve	Set	1		
SHUMA D					
SHUMA A+ SHUMA B+ SHUMA C+ SHUMA D					
TVSH 20%					
TOTALI					

Sqarojmë se faturimi dhe dokumentacioni për zërat e preventivit, do të jetë si më poshtë:

Seksioni A: zëri 1, zëri 2, zëri 3; **Seksioni B:** zëri 1; janë paketa shërbimi fikse gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes 3-vjeçare, konsumi i të cilave do të jetë periodik për platformën DMDC që përfshihet në këto terma reference. Të gjithë këto zëra, janë paketa shërbimi, të cilat do të faturohen çdo 3 (tre) muaj duhet të shoqërohen me dokumentacionin:

1. Raporti 3 (tre) mujor i miratuar nga Prodhuesi i sistemit DMDC PROZANET, ku duhet të përshkruhen me detaje proceset e punëve të kryera gjatë suportit online, mirëmbajtjes preventive dhe suportit për eliminimin e eroreve.
2. Akt pranimi të shërbimit nga personi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës nga KESH sh.a. dhe grupi i marrjes në dorëzim për shërbimin/et e mirëmbajtjes së kryer nga Prodhuesi ose specialistët e autorizuar nga Prodhuesi.

Seksioni B: zëri 2, është paketë shërbimi fikse gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes 3-vjeçare, konsumi i të cilave do të jetë periodik për platformën DMDC që përfshihet në këto terma reference. Ky zë është paketa shërbimi, i cili do të faturohet 1 (një) herë në çdo vit (periudha e kryerjes sipas rastit gjatë secilit vit), Duhet të shoqërohet me dokumentacionin:





1. Raporti vjetor i gjeneruar nga Prodhuesi i sistemit DMDC PROZANET, ku duhet të përshkruhen me detaje proceset e punëve të kryera gjatë suportit online, mirëmbajtjes preventive dhe suportit për eliminimin e eroreve dhe kryerja e backup-eve në rast ndryshimesh ose shtesash në konfigurime dhe sinjale.
2. Akt pranimi të shërbimit nga personi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës nga KESH sh.a. dhe grupi i marrjes në dorëzim për shërbimin/et e mirëmbajtjes së kryer nga Prodhuesi ose specialistët e autorizuar nga Prodhuesi.

Seksioni C: zëri 1, kur të kryhet Integrimi i kapaciteteve të reja gjeneruese në sistemin SCADA DMDC PROZANET, sipas specifikimeve. Duhet të shoqërohet me dokumentacionin:

1. Akt Kolaudimi dhe Çertifikatë e marrjes në dorëzim.

Seksioni C: zëri 2, zëri 3, Zgjerimi i kapacitetit të licensës ekzistuese SCADA të Platformës DMDC në KESH Qendër dhe DMDC Backup në HEC Vau i Dejës me të paktën 1000 sinjale. Duhet të shoqërohet me dokumentacionin:

1. Licensa e gjeneruar nga prodhuesi i sistemit DMDC;
2. Akt Kolaudimi dhe Çertifikatë e marrjes në dorëzim.

Trajnimi i avancuar Seksioni C: zëri 1, do të shoqërohet me dokumentacionin:

1. Manualet e trajnimit të gjeneruar nga Prodhuesi.
2. Kopje të noterizuara të Çertifikatave të lëshuara nga Prodhuesi për secilin specialist pjesëmarrës të KESH sh.a., të përkthyer dhe të noterizuara.
3. Raport nga grupi i specialistëve të KESH sh.a., pjesëmarrës në trajnim sipas objektit dhe zërit në preventiv, mbi realizimin dhe ezaurimin e plotë të ditëve të kërkuara për trajnim, realizimin dhe ezaurimin e temave të trajnimit sipas specifikimeve të kërkuara në kontratë.
4. Proces verbal i përbashkët midis Personit Përgjegjës për Ndjekjen e zbatimit të kontratës nga KESH sh.a. dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik për trajnimin e kryer nga Prodhuesi.

Aksesi në rrjetin (network) e KESH sh.a. për të kryer mirëmbajtjen në distancë online, do të sigurohet nga KESH sh.a. (remote maintenance access to network provided by customer)

Për çdo emër ose markë që është përdorur më sipër është i vlefshëm termi “ekuivalent”.